

Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. Hyrje dhe prioritetet e Misionit

1. Ky raport parashtrohet në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, përmes së cilës Këshilli themeloi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe kërkoi nga unë që të raportoj në intervale të rregullta kohore për zbatimin e mandatit të tij. Në këtë raport mbulohen aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet lidhur me to, duke filluar nga data 16 tetor 2018 deri më 15 janar 2019.
2. Prioritetet e Misionit mbesin avancimi i sigurisë, stabilitetit dhe i respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë e regjion. Në arritjen e objektivave të tij, UNMIK-u vazhdon angazhimin konstruktiv me Prishtinën dhe Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë dhe me palët regjionale e ato ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë së zbatuari të roleve të tyre brenda kornizës së Rezolutës 1244 (1999). Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) vazhdon praninë e tij në Kosovë në përputhje me deklaratën e kryetarit të Këshillit të Sigurimit, të datës 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44) dhe me raportin tim të datës 24 nëntor 2008 (S/2008/692). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara bashkëpunojnë ngushtë me Misionin.

II. Zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë

3. Gjatë periudhës raportuese, tensionet në mes të Beogradit dhe Prishtinës vazhduan të rriten, duke ndikuar në perspektivën e një dialogu produktiv. Më 6 nëntor, qeveria e Kosovës vendosi 10 për qind taksë për mallrat nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, duke ju referuar “Këmbënguljes së Beogradit për të dobësuar pozitën ndërkombëtare të Kosovës” si arsyen kryesore pas këtij vendimi. Më 21 nëntor, një ditë pas një votimi në Asamblenë e Përgjithshme të INTERPOL-it ku Kosova nuk u pranua si anëtare, qeveria e Kosovës e rriti taksën e importit për mallrat nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina në 100 për qind, dhe ndaloi hyrjen në Kosovë të të gjitha mallrave të etiketuar “UNMIK Kosova” dhe “Kosova e Metohija”. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, shpjegoi se këto masa ishin reagim i “viteve të tëra të fushatave nga Beogradi për të dëmtuar përpjekjet e Kosovës që t’u bashkohet organizatave ndërkombëtare”. Më 28 dhjetor, qeveria e Kosovës lajmëroi se tarifa prej 100 për qind do të zbatohet gjithashtu edhe për brendet ndërkombëtare të prodhuara në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë, që më parë ishin të përjashtuara nga kjo masë.
4. Si reagim ndaj rritjes së taksës për import nga qeveria e Kosovës, më 27 nëntor, kryetarët e katër komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës lajmëruan dorëheqjet e tyre, dhe se

asamblētë e tyre përkatëse do të ndërpresin komunikimet zyrtare me autoritetet në Prishtinë. Partia kryesore serbe në Kosovë, Lista Serbe, e cila nga marsi i vitit 2018 kishte refuzuar pjesëmarrjen në seancat formale të qeverisë apo të Kuvendit të Kosovës, organizoi së paku 15 protesta të përqendruara në veri të Mitrovicës, që ndonjëherë përfshinin deri më 7,500 njerëz. Kryetari i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e quajti vendimin e Prishtinës shkelje të Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), dhe theksoi se Beogradi do të vazhdojë përfshirjen në dialogun e përkrahur nga BE-ja në mes të Beogradit dhe Prishtinës kur kjo e fundit ta revokojë taksën për import. Në fund të nëntorit, kryeministri i Serbisë dhe ministri i tregtisë së jashtme dhe marrëdhënieve ekonomike i Bosnjës dhe Hercegovinës, kërkoi konsultime të përbashkëta në kuadër të Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s, për masën e tregtisë të paraqitur nga qeveria e Kosovës. Konsultimet ende nuk ishin caktuar deri në fund të periudhës raportuese. Midis retorikës dhe tensioneve të shtuara, një takim i Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s, i mbajtur më 6 dhjetor në Prishtinë, nuk mundi të përfundohej për shkak të largimit të delegacionit të Prishtinës dhe Tiranës pas një deklarate kontestuese nga një përfaqësues i Beogradit. UNMIK-u shprehu gatishmërinë për të marrë pjesë në konsultimet e ardhshme të parapara në Komitetin e Përbashkët të CEFTA-s për çështjen e tarifave, me qëllim të mbështetjes së një dialogu konstruktiv në këtë kornizë.

5. Akterët ndërkombëtarë i bënë thirrje qeverisë së Kosovës të revokojë masat e tregtisë. Përfaqësuesi im Special ka nxjerrë dy deklarata duke shprehur shqetësim për ndikimin e taksës së importit tek popullata e Kosovës, dhe duke potencuar domosdoshmërinë për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit. Më 21 nëntor, Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë /Nënkryetare e Komisionit Evropian, Federika Mogherini, tha se masat e taksës ishin shkelje e dukshme e CEFTA-s dhe e frymës së Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Zyrtarët e lartë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë edhe Përfaqësuesen e Lartë dhe Komisionarin për Politika Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat për Zgjerim, Johannes Hahn, u angazhuan në një diplomaci intensive për të inkurajuar dialogun në mes të Beogradit dhe Prishtinës, me fokus në zgjidhjen e çështjeve të tregtisë. Akterë të tjerë ndërkombëtarë po ashtu kanë kërkuar nga Kosova ta shfuqizojë taksën. Mirëpo, kryeministri i Kosovës, insistoi që çështjet tregtare duhet diskutuar me Beogradin së bashku me çështjet tjera në agjendën e dialogut të përkrahur nga BE-ja, dhe se masat do të hiqen vetëm atëherë kur Serbia ta njohë Kosovën.
6. Në mesin e një atmosfere të tensionuar, më 14 dhjetor Kuvendi i Kosovës miratoi një ligj për Forcën e Sigurisë së Kosovës, një ligj për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe një ligj për Ministrinë e Mbrojtjes. Ligjet e reja u shpallën nga Presidenti i Kosovës më 28 dhjetor dhe parashohin ndryshime substanciale të mandatit, rolit dhe kapacitetit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilat duhet të implementohen gjatë një periudhe kohore. Qeveria e Kosovës, në një deklaratë të lëshuar pas miratimit të ligjeve, theksoi të drejtën e Kosovës të ketë “një ushtri, një forcë multietnike dhe profesionale, e ndërtuar sipas standardeve më të larta të NATO-s”. Në një komunikatë të lëshuar më 15 dhjetor, Lista Serbe theksoi se

tranzicioni i menduar i Forcës së Sigurisë së Kosovës do të shihej si kërcënim nga serbët e Kosovës. Autoritetet serbe e dënuan miratimin e këtyre ligjeve, duke i karakterizuar ata si akt i “agresionit politik” kundër Serbisë dhe shkelje e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999). Ata gjithashtu kërkuan nga KFOR-i të mos lejojë veprimin e ndonjë “Ushtrie të Kosovës” në territorin e Kosovës. Presidenti Vuçiq tha se Beogradi do të reagojë ndaj çdo tentimi për të dërguar Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe cilat do njësi të armatimit të rëndë të kontrolluara nga Prishtina në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. Më 17 dhjetor, me kërkesën e Serbisë u mbledh Këshilli i Sigurimit për të diskutuar gjendjen në Kosovë.

7. Në ditën e miratimit të legjislacionit për Forcën e Sigurisë së Kosovës nga Kuvendi i Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), derisa theksoi se tranzicioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës në parim ishte çështje për Kosovën që ta vendosë, shprehu keqardhje për këtë vendim, duke e karakterizuar si “të pakohë” dhe të miratuar përkundër shqetësimeve të shprehura paraprakisht nga NATO. Ai shtoi se ky vendim do të kërkojë rishqyrtim të angazhimit të NATO-s me Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ai po ashtu theksoi zotimin e vazhdueshëm të NATO-s, përmes KFOR-it, për një ambient të qetë e të sigurt në Kosovë. Zëdhënësi i Shërbimit Evropian për Punë të Jashtme (EEAS), në të njëjtën ditë theksoi se mandati i Forcës së Sigurisë së Kosovës duhet të ndryshohet vetëm përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe gradual, në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, duke shtuar se Bashkimi Evropian ka pritur që Kosova të vazhdojë me përmbushjen e detyrimeve sipas “Marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve” të prillit 2013 dhe masat e saj për sigurinë. Në deklaratën time të së njëjtës ditë, unë theksova se Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) parasheh kornizën e vetme ligjore për praninë e sigurisë ndërkombëtare, KFOR-it, të cilit i besuar përgjegjësia për të siguruar ambient të qetë e të sigurt në Kosovë, dhe se çfarëdo kufizimi i kryerjes së përgjegjësive të sigurisë nga KFOR-i do të ishte i papajtueshëm me këtë rezolutë. Përfaqësuesi im Special ka dhënë një deklaratë të ngjashme në Prishtinë.
8. Në ndërkohë, vazhduan përpjekjet për unifikimin e qasjes së Prishtinës me atë të Beogradit për dialogun e mbështetur nga BE-ja. Më 15 dhjetor Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë për dialogun, me të cilën u themelua një ekip negociator i bashkëdrejtuar nga zëvendëskryeministri Fatmir Limaj nga partia e koalicionit qeverisës Iniciativa për Kosovën, dhe nga kryetari i Prishtinës Shpend Ahmeti nga Partia opozitare Socialdemokrate e Kosovës. Ky ekip përfshin anëtarë të tjerë nga koalicioni qeverisës dhe nga Partia Socialdemokrate e Kosovës, si dhe nga shoqëria civile por jo Lista Serbe. Tri ditë pas miratimit të rezolutës, kryeministri Haradinaj i paraqiti kabinetit të tij të ministrave propozimin e tij për një sërë çështjesh sektoriale për negociatat me Beogradin. Ashtu siç parashihet në rezolutë, më 24 dhjetor, qeveria e Kosovës i dorëzoi Kuvendit një projektligj për “detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.” Partitë kryesore opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje kritikuan të gjitha këto iniciativa, duke i quajtur të paligjshme. Përveç

kësaj, Liste Serbe dhe autoritetet në Beograd theksuan se këto iniciativa nuk lënë hapësirë për kompromis. Beogradi gjithashtu kritikoi emërtimin e Fatmir Limajt në ekipin negociator të Prishtinës, i cili më parë ishte gjykuar për krime lufte por që ishte liruar.

9. Pas takimit të rregullt të tretë të Këshillit për Stabilizim dhe Asociim në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës më 17 dhjetor në Bruksel, Bashkimi Evropian e mirëpriti progresin e Kosovës në implementimin e agjendës evropiane për reforma, dhe bëri thirrje për implementim të shpejtë të masave të pazbatuara. Më 19 dhjetor, kryetari i Serbisë Vuçiq dhe kryetari i Kosovës Thaçi morën pjesë në një takim të liderëve të Ballkanit perëndimor, të drejtuar nga Përfaqësuesja e Lartë Mogerini në Bruksel, ku të gjithë pjesëmarrësit u zotuan të punojnë bashkërisht duke ndjekur rrugët e tyre përkatëse evropiane.
10. Në një zhvillim tjetër, përfaqësuesit e qeverisë së Shqipërisë dhe autoritetet e Kosovës e mbajtën takimin e tyre vjetor më 26 nëntor në komunën e Pejës, gjatë së cilës ata nënshkruan një sërë marrëveshesh për rritjen e bashkëpunimit ekonomik, duke përfshirë edhe thjeshtësimin e procedurave bilaterale doganore. Më pas, kryeministri i Shqipërisë dhe ai i Kosovës po ashtu shprehën zotimin e tyre për të avancuar “menaxhimin e përbashkët të kufirit.”
11. Gjatë periudhës raportuese, kanë ndodhur disa incidente ndërkomunitare. Më 21 tetor u bllokua rruga për në manastirin e Studenicës në fshatin Studenicë në komunën e Istogut, dhe u gjuajtën gurë në dy autobus të cilët ishin duke transportuar përafërsisht 170 serbë që vizitonin manastirin. Liderët institucional të Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare e dënuan këtë incident. Përfaqësuesi i Special lëshoi një deklaratë duke kërkuar respektim të lirisë së lëvizjes dhe religjionit në Kosovë. Më 28 tetor, Policia e Kosovës raportoi se është gjetur një granatë dore e pashpërthyer përpara shtëpisë së një pjesëtari turk të Kosovës në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në lagjen etnikisht të përzier në mëhallën boshnjake në veri të Mitrovicës. Më 14 nëntor, në lagjen e njëjtë, një automjet pronë e një kompanie farmaceutike e financuar nga qeveria e Serbisë u shkatërrua dhe u mbulua me grafitë, dhe u dëmtuan pesë automjete pronë e shqiptarëve të Kosovës në veri të Mitrovicës.
12. Qeveria e Kosovës vazhdoi me ndërmarrjen e veprimeve për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm. Më 16 tetor, themeloi një komision ndërinstitutional i ngarkuar për të monitoruar dhe raportuar për çështje që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm. Më 21 nëntor, Gjykata e apelit nxori aktgjykim duke konfirmuar verdiktin e Gjykatës themelore të Prishtinës, e cila më 18 maj kishte liruar për mungesë të dëshmive pesë imamë, të akuzuar për vepra që lidhen me terrorizëm. Më 20 dhjetor, Prokuroria speciale ngriti aktakuzë kundër një individi për veprën penale të pjesëmarrjes në grupe terroriste.

III. Kosova e veriut

13. Që nga vendosja e taksës për mallrat nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina nga autoritetet e Kosovës, UNMIK-u dhe Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Kosovë nuk kanë vërejtur ndonjë ndikim të dukshëm të qasjes në mallra dhe shërbime esenciale për banorët e veriut të Kosovës. Në të njëjtën kohë, asnjë nga mediat e shkruara në gjuhën serbe, duke përfshire edhe gazetatat ditore, nuk kanë hyrë në Kosovë pas rritjes së taksës.
14. Gjatë periudhës nën shqyrtim, nuk ka pas përparim në rihapjen e urës kryesore në Mitrovicë, që ishte mbyllur për qarkullimin e automjeteve në qershor të vitit 2014. Pas një takimi të përkrahur nga BE-ja në mes të kryetarëve të veriut dhe jugut të Mitrovicës, më 2 tetor, kryetari i Mitrovicës jugore e kritikoi bashkësinë ndërkombëtare për dështimin në rihapjen e urës dhe kërcënoi se do ta hapë në mënyrë të njëanshme. Në deklaratat e më pastajme, kryetari i Mitrovicës jugore e inkurajoi qeverinë e Kosovës t'ia dorëzojë Kuvendit të Kosovës një propozim për bashkimin e veriut dhe jugut të Mitrovicës. Lista Serbe menjëherë e dënoi këtë propozim.
15. Në një zhvillim tjetër, më 23 nëntor, policia speciale e Kosovës arrestoi katër serbë të Kosovës në veri të Mitrovicës, duke përfshirë dy pjesëtarë të Policisë së Kosovës, në lidhje me hetimet për vrasjen e politikanit të ndjerë serb të Kosovës Olliver Ivanoviq. Sipas Policisë së Kosovës, dështoi operacioni për arrestimin e një tjetër të dyshuari, një politikan të shquar serb të Kosovës. Deri në fund të periudhës raportuese, nga katër të arrestuarit njëri u lirua pas dy ditësh, kurse tre të tjerët mbetën në paraburgim.

IV. Normalizimi i marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës

16. Më 8 nëntor, në Bruksel u takuan presidenti i Serbisë Vuçiq dhe presidenti i Kosovës Thaçi, nën organizimin e Përfaqësues së Lartë të BE-së Mogerini, brenda kornizës së dialogut të përkrahur nga BE-ja në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Pas takimit, zëdhënësi i Shërbimit Evropian për Punë të Jashtme (EEAS) u bëri thirrje Beogradit dhe Prishtinës që “të lëvizin me hapa të shpejtë në zotimin e tyre për dialogun, duke ditur lidhjen direkte në mes të normalizimit të plotë të marrëdhënieve në mes tyre dhe perspektivës konkrete të aspiratave të tyre për në BE”. Presidenti i Serbisë pas takimit tha se nuk ishte pjesë e dialogut politik me Prishtinën, të cilin tha se do ta rifillojë vetëm pasi Prishtina të tërheqë vendimin për taksën e importit. Nga ana tjetër, presidenti Thaçi e akuzoi presidentin Vuçiq për “dhënien e ultimatumëve” dhe pasjen e një “qasjeje të padobishme” për dialogun.
17. Më 8 janar, ekipi negociator i Prishtinës u takua me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së Mogerini në Bruksel, për të diskutuar dialogun e përkrahur nga BE-ja në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Përfaqësuesja e Lartë tha se prania e delegacionit të Prishtinës në Bruksel ishte demonstrim i prioritetit që autoritetet e Kosovës i jepnin procesit të normalizimit, i cili ishte kusht për rrugën evropiane të Kosovës. Përfaqësuesja e Lartë potencoi nevojën që të dyja

palët të implementojnë marrëveshjet e kaluara dhe t'u shmangen veprimeve dhe deklaratave që nuk ishin në pajtim me interesin e përgjithshëm dhe me objektivat strategjike të rajonit. Ajo po ashtu përsëriti urgjencën për të revokuar tarifën doganore të vendosur nga autoritetet e Kosovës. Sa u përket atyre, bashkëkryesuesit e ekipit negociator të Prishtinës theksuan se ata ishin mandatuar nga Kuvendi i Kosovës për të përfaqësuar interesat e popullit të Kosovës në dialogun me Beogradin, dhe theksuan nevojën që Beogradi të demonstrojë mirëbesim në procesin e negociatave para se Prishtina të marrë parasysh revokimin e masave tregtare.

V. Kthimet, pajtimi, trashëgimia kulturore dhe marrëdhëniet në komunitet

18. Gjatë periudhës raportuese, Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) regjistroi 93 kthime vullnetare të njerëzve, të cilët paraprakisht kishin qenë të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, kryesisht në komuna ku ata nuk janë shumicë. Aty përfshiheshin 43 gra dhe 50 burra; 32 serbë, 18 egjiptian, 18 rom, 16 ashkali, tetë shqiptarë dhe një kroat. Që nga viti 2000, 28,111 pjesëtarë të zhvendosur të komuniteteve joshumicë kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë (13,793 gra dhe 14,318 burra; 11,945 serbë, 7,577 egjiptian dhe ashkali, 3,925 romë, 1,875 boshnjak, 1,464 goranë, 1,281 shqiptarë, 21 malazezë, 19 turq dhe katër kroat). Në vitin 2018, 327 pjesëtarë të zhvendosur të komuniteteve joshumicë, duke përfshirë 154 gra dhe 173 burra, kanë gjet zgjidhje afatgjate në Kosovë. Përveç 16,254 personave të zhvendosur në Kosovë, janë akoma 69,627 persona me nevoja që ndërlidhen me zhvendosjen në mbarë rajonin e Ballkanit perëndimor, nga përafërsisht 200,000 persona të zhvendosur nga Kosova që banojnë në këto shtete (ku shumica janë në Serbi).
19. Sfidat lidhur me kthimin e pronës, ndarjen e tokave për ndërtime banesore, siguria dhe mundësitë socio-ekonomike për të kthyerit kanë vazhduar të pengojnë progresin për kthime të qëndrueshme. Si pjesë e përpjekjeve për të mundësuar kthimet, më 2 nëntor, përfaqësuesit nga zyrat komunale për komunitete dhe kthim në komunën e Pejës morën pjesë në një punëtori për implementimin e rregullores së qeverisë për kthim të personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme. Më 12 nëntor, komuna e Kamenicës filloi me shpërndarjen e shujtave ditore për nxënësit e shkollave fillore në mbarë komunën, duke përfshirë edhe pesë shkolla ku mësimin e vijonin fëmijët e serbëve dhe romëve që mësonin sipas planprogramit serb.
20. Qeveria e Kosovës, me përkrahjen e Qendrës Evropiane për Çështje të Pakicave, vazhdoi të punojë ngushtë me Universitetin e Mitrovicës, për t'u lëshuar diploma të diplomuarve të universitetit, të cilat mund të përdoren për qëllime të aplikimit për punë në institucionet publike të Kosovës. Më 30 nëntor, komisioni i pavarur për certifikimin e diplomave i qeverisë së Kosovës raportoi se, që nga themelimi në vitin 2015, kishte pranuar 1,535 aplikacione, nga të cilat 1,350 ishin certifikuar, 144 ishin në pritje të shqyrtimit, 38 ishin refuzuar dhe për tri nevojiteshin formularë shtesë.
21. Këshilli për implementim dhe monitorim, që mbikëqyrë zonat e mbrojtura speciale përreth

objekteve religjioze u takua më 6 nëntor, për të diskutuar një ndërtim të propozuar të një qendre administrative të Bashkësisë Islame në komunën e Lipjanit, që do të bie brenda zonës së mbrojtur speciale të Kishës Ortodokse Serbe të “Kishës së Dëftimit të Shën Mërisë”. Me kërkesë të Eparkisë së Rashkës-Prizren, departamenti komunal i planifikimit, urbanizmit dhe mjedisit e ngriti çështjen në Këshillin për implementim dhe monitorim. Takimi u pasua me një vizitë në objekte më 15 nëntor, ku Këshilli për implementim dhe monitorim ka mundësuar bisedimet ndërmjet komuniteteve religjioze dhe komunës për gjetjen e një zgjidhjeje.

22. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u vazhdoi të monitorojë zhvillimet lidhur me të drejtat e komunitetit ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Mungesa e qasjes në arsim, braktisja e vazhdueshme e shkollës dhe dokumentet e pakompletura apo të pagjetura të gjendjes civile, posaçërisht certifikatat e lindjes, vazhdojnë të ndikojnë negativisht në integrimin e këtyre grupeve në shoqërinë kosovare. UNHCR-ja vazhdoi me përkrahjen e pjesëtarëve të komunitetit ashkali, egjiptian dhe rom në Kosovë në marrjen e dokumenteve civile dhe zgjidhjen e çështjeve të gjendjes civile, për të mundësuar qasjen e tyre në shërbime publike. UNHCR-ja ndihmoi 99 individë (54 gra dhe 45 burra) në marrjen e dokumentacionit civil. Në ndërkohë, është pranuar një shkresë fillestare e interesit për të kontribuar në fondin e mirëbesimit për mbështetjen e komunitetit ashkali, egjiptian dhe rom, të prekur nga helmimi me plumb në Kosovë, i krijuar në vitin 2017 për të zbatuar rekomandimet e Panelit këshillëdhënës të UNMIK-ut për të drejtat e njeriut.

VI. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut

23. Më 25 tetor, Kuvendi i Kosovës miratoi në lexim të parë një projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, i cili parasheh gjykime në mungesë të individëve të dyshuar për kryerjen e krimeve të luftës në Kosovë ndërmjet janarit 1990 dhe qershorit 1999. Disa organizata të shoqërisë civile shprehën shqetësim për implikim të të drejtave të njeriut të gjykimeve në mungesë. Komuniteti serb i Kosovës shprehu shqetësim se krimet e kryera pas 1999 nuk do t'i nënshtrohen këtij ligji.
24. Më 5 nëntor, gjykata themelore në Prishtinë e dënoi ish-kryetarin e Lipjanit për abuzim të pozitës së tij zyrtare dhe e dënoi atë me tre vite burgim. Gjykata gjeti fajtor edhe pesë ish-zyrtarë të komunës së Lipjanit dhe liroi tre të tjerë.
25. Përveç kësaj, më 25 tetor, gjykata themelore në Prishtinë e dënoi një ish-pjesëtar të një njësie paramilitare serbe, i cili është me prejardhje romë nga Kosova, me dhjetë vite burgim për krime lufte të kryera në vitin 1999 kundër popullatës civile. I pandehuri ishte ekstraduar nga Bosnja dhe Hercegovina në dhjetor të vitit 2016, kurse një pjesëtar tjetër i njësisë së njëjtë paramilitare, me prejardhje etnike serbe, ishte dënuar që në vitin 2014. Më 14 nëntor, Gjykata e apelit e Kosovës e konfirmoi një aktvendim të mëhershëm të gjykatës themelore në Gjakovë, duke e liruar Fatmir Limajn, zëvendëskryeministër dhe lider i partisë në koalicionin qeverisës Nisma për Kosovë, nën akuza të përgjegjësi komanduese për vrasjen e dy shqiptarëve në vitin

1998. Më 15 nëntor, prokurorja speciale e Kosovës lajmëroi rihapjen e një rasti për dhunim, në të cilin kryerësit e pretenduar ishin liruar në vitin 2014. Ajo potencoi se dhunimi në fjalë ishte përdorur si “armë e luftës” dhe shpjegoi se hetimet e rihapura do të përqendroheshin në përgjegjësinë komanduese.

26. Gjatë periudhës nën shqyrtim, “Grupi i përbashkët punues për persona të pagjetur lidhur me ngjarjet në Kosovë” miratoi procedurat në mes të autoriteteve të Beogradit dhe Prishtinës për dorëzimin e mbetjeve njerëzore të zhvarrosura në të dyja anët e vijës administrative, një zhvillim që kontribuoi në rritjen e bashkëpunimit në mes të Beogradit dhe Prishtinës për çështjen e personave të pagjetur. Më 26 tetor, UNMIK-u mori pjesë në takimin e 48-të të grupit të përbashkët punues. Në këtë takim, Komiteti Ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq raportoi se 1,647 persona janë akoma të pagjetur që nga 2018, kurse fati dhe vendndodhja e vetëm shtatë individëve u sqarua në vitin 2018.
27. Komisioni i qeverisë së Kosovës përgjegjës për verifikimin dhe njohjen e statusit të të mbijetuarit nga dhuna seksuale gjatë konfliktit, që u themelua në shkurt të vitit 2018, pranoi 108 aplikacione gjatë periudhës raportuese, duke e rritur numrin në 890. Nga këto, 175 (169 gra dhe gjashtë burra) deri tani ka rezultuar se e kanë fituar statusin e të mbijetuarit. Për të shënuar përvjetorin e 18-të të rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1325 (2000), Entiteti i Kombeve të Bashkuara për barazi gjinore dhe fuqizim të grave (UN Women) organizoi një ekspozitë artistike, “Ngjyrat e shpirtrave tanë”, më 5 nëntor. Kjo ekspozitë paraqiti punime artistike të krijuara nga të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë konfliktit, dhe ngriti vetëdijen për stigmën që i rrethon të mbijetuarit me paraqitjen e vizioneve të tyre të paqes.

VII. Gratë, paqja dhe siguria

28. Në kornizën e implementimit të rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1325 (2000), më 16 nëntor, UN Women dhe Lobi i grave rajonale për paqe, siguri dhe drejtësi në Evropën juglindore, me përkrahjen e koordinatorit për zhvillim të KB-së në Kosovë, UNMIK-u dhe Ambasada e Suedisë në Prishtinë, organizoi një konferencë rajonale për pjesëmarrjen e grave në përpjekjet për ndërtimin e paqes në Ballkanin perëndimor. Pjesëmarrësit nga sektorë të ndryshëm nga mbarë rajoni avokuan për pjesëmarrje kuptimplote të grave në proceset vendimmarrëse dhe përfshirjen e tyre në procese të ndërmjetësimit dhe ndërtimit të paqes.

29. Gjatë periudhës raportuese, përpjekjet vazhduan të fuqizojnë dhe të rreshtojnë kornizën ligjore të Kosovës për trajtimin dhe parandalimin e dhunës në baza gjinore me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të cilin Kuvendi i Kosovës e miratoi në leximin e tij të parë më 25 tetor, përfshinte një përkufizim të dhunës në familje si vepër e veçantë penale. Anëtarët e grupit shumëpalësh për siguri dhe çështje gjinore, që kryesohet nga UNWomen dhe përfshin UNMIK-un, kanë avokuar për ndryshimet.
30. Gjatë fushatës 16 ditore të aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore, u bënë përpjekje për vetëdijësimin publik që synon parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, që filloi më 25 nëntor me temën “Ngjyrose botën me ngjyrë portokalli: #Më dëgjo edhe mua”. Kjo fushatë përfshiu më shumë se 100 ngjarje dhe aktivitete të organizuara nga akterë ndërkombëtarë, joqeveritarë dhe të shoqërisë civile, nën koordinimin e grupit shumëpalësh për siguri dhe çështje gjinore.
31. Gjatë fushatës, në Prishtinë u paraqit dokumentari i përgatitur nga UNMIK-u “Nuk është prona jote”, që u pasua me shfaqjen e tij në dhjetë komuna të Kosovës, të organizuar në bashkëpunim me UN Women dhe të drejtuar nga autoritetet vendore dhe partnerët e shoqërisë civile. Ky dokumentar u shfaq nga transmetuesi publik Radio Televizioni i Kosovës, që u pasua me një diskutim paneli në televizion të shikuar nga dhjetëra mijë shikues, duke përfshirë edhe mediat sociale. Kjo fushatë u përmbyll me një konferencë rajonale të nivelit të lartë mbi “Qasjen në drejtësi të viktimave të dhunës në familje dhe asaj në baza gjinore”, të organizuar nga Zyra e Koordinatorit të Kosovës për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe të përkrahur nga UNWomen dhe nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Në fund të fushatës, grupi për siguri dhe çështje gjinore nxori një shkresë avokimi duke ju bërë thirrje institucioneve qendrore dhe lokale të ndajnë fonde për strehimoret e dhunës në familje në buxhetin e vitit 2019. Më 26 dhjetor, Komisioni për buxhet dhe financa i Kuvendit të Kosovës rekomandoi rritjen e financimit, e cila rritje, që është në pritje të miratimit të buxhetit të vitit 2019 nga Kuvendi, do të mundësojë financim të qëndrueshëm gjatë tërë vitit për strehimoret dhe do të parandalojë mbylljen e tyre nga mungesa e resurseve, siç ishte rasti në fund të vitit 2018.

VIII. Partneriteti dhe bashkëpunimi

32. Më 18 tetor, në kuadër të aktiviteteve pasuese të Forumit të Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Besimit, të mbajtur në Lubjanë në maj të vitit 2018, UNMIK-u mblodhi më shumë se 200 pjesëmarrës, duke përfshirë zyrtarët e pushtetit lokal dhe atij qendror, udhëheqësit fetarë, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe ata të bashkësisë ndërkombëtare për të vlerësuar përparimin dhe për të identifikuar hapat e ardhshëm prioritarë në zbatimin e rekomandimeve të Forumit. Përfaqësuesi im special kërkojë ndërmarrjen e hapave konkretë, dhe ftojë të gjithë udhëheqësit dhe partnerët kosovarë që t’i bashkohen Kombeve të Bashkuara në çuarjen përpara të rekomandimeve të Forumit, që janë udhëzuese të përpjekjeve të përgjithshme drejt arritjes

së pajtimit të qëndrueshëm.

33. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u në bashkëpunim të ngushtë me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, filloi me zbatimin e disa aktiviteteve programatike për ndërtimin e besimit në fushën e gjuhëve dhe të drejtave të njeriut, fuqizimit të rinisë, barazisë gjinore dhe të dialogut ndërkomunitar. Me qëllim të avancimit të të drejtave gjuhësore dhe të qasjes në drejtësi, UNMIK-u përkrahu përpjekjet në zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura në Gjykatën themelore të Mitrovicës përmes angazhimit të dhjetë përkthyesve dhe të dy asistentëve ligjorë. UNMIK-u gjithashtu hyri në partneritet me dy organizata rinore joqeveritare në zbatimin e projekteve që kanë për qëllim nxitjen e pajtimit të qëndrueshëm përmes trajnimeve për të drejtat e njeriut dhe fuqizimit të rreth 1000 të rinjve, duke ua zgjeruar horizontin e njohurive të tyre për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
34. Nga data 17 tetor deri më 20 dhjetor, UNMIK-u përkrahu ekipin shumetnik të udhëheqësve të rinj në organizimin e një numri aktiviteteve që kishin për qëllim fuqizimin e vajzave në shkolla lidhur me luftimin e dhunës gjinore përmes orëve shkollore të këshillimit profesional dhe vetëmbrojtjes. Po kështu, me qëllim të përkrahjes së pjesëmarrjes së rinisë në proceset lokale të vendimmarrjes, UNMIK-u u përqendrua në dhënien e përkrahjes bordeve këshillëdhënëse komunale të rinisë – Këshillave lokale vepruese të rinisë – dhe në rritjen e kapaciteteve të tyre për dialogun ndërkomunitar. Gjatë periudhës raportuese, kryetari i komunës së Kamenicës vazhdoi me avancimin e barazisë gjinore në komunë, e cila ka numrin më të madh të grave në pozita udhëheqëse në Kosovë. UNMIK-u dha ndihmesë në pajisjen e sallës së mbledhjeve të grupit të grave asamblesite të kuvendit komunal të Kamenicës, e cila u inaugurua më 12 nëntor dhe e cila ia mundëson pushtetit vendor takimet e rregullta me zgjedhësit e tyre, ku diskutohen dhe avancohen prioritetet e çështjeve gjinore në agjendën e aktiviteteve komunale.
35. UNMIK-u vazhdoi me ofrimin e shërbimeve të vërtetimit të dokumenteve. Gjatë periudhës nën shqyrtim, janë përpunuar gjithsej 868 dokumente, ku 502 prej tyre kanë qenë të ndërlidhur me pensionet dhe 366 me gjendjen civile, siç janë diplomat e shkollës së mesme, si dhe certifikatat e martesës, të lindjes dhe ato të vdekjes. UNMIK-u gjithashtu vazhdoi me lehtësimin e bashkëpunimit dypalësh policor mes autoriteteve të Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (janë pranuar dhe përpunuar 68 kërkesa). UNMIK-u po ashtu dha ndihmesë në lëshimin e 19 letërreshtimeve të INTERPOLIT dhe në katër kërkesa për ekstradim që Kosovës ia dërguan katër shtete anëtare të INTERPOLIT. Po kështu, hapi edhe 447 raste për hetime brenda bazës së të dhënave të INTERPOLIT, duke e sjellë kështu gjithsej numrin e rasteve të hapura që ndërlidhen me territorin e Kosovës apo me banorët e saj në 1494. Gjatë periudhës raportuese UNMIK-u gjithsej pati 3759 korrespondenca zyrtare në kuadër të funksionit të tij ndërlidhës me INTERPOLIN.

IX. Vrojtimet

36. Jam i shqetësuar për tensionet mes Beogradit dhe Prishtinës dhe për rreziqet e ndërlidhura ndaj stabilitetit në terren, posaçërisht në Kosovën e veriut. Së këndejmi, është thelbësore që liderët e të dyja palëve t'i shmangen çfarëdo veprimi që do të mund t'i rriste tensionet edhe më shumë dhe që të bëjnë gjeste pajtuese e të kërkojnë mënyra për riangazhim dhe punën drejt përparimeve në dialogun e mbështetur nga BE-ja, që ka për qëllim normalizimin e marrëdhënieve të tyre.
37. Duke qenë të vetëdijshëm për sfidat, me të cilat Beogradi dhe Prishtina ballafaqohen në gjetjen e zgjidhjes, dëshiroj t'i inkurajoi liderët e të dyja palëve që të kalojnë prej dinamikës së dy kundërshtarëve në atë të zgjidhjes së problemeve. Për ta bërë këtë, është e rëndësishme që të dilet nga pozicionet e ngurtësuar dhe që të tregohet përkushtim në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, duke u angazhuar drejt heqjes së pengesave dhe krijimit të kushteve të volitshme për rinisjen e dialogut.
38. Mirëpres themelimin e ekipit negociator në Prishtinë për dialogun e mbështetur nga BE-ja dhe angazhimin e tij të parë me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së. Po ashtu, dua të inkurajoj pjesëmarrje më të madhe të grave në procesin e dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës në përputhje me përkushtimet e tyre përkatëse në avancimin e grave dhe të agjendës së paqes e sigurisë, si dhe përfshirjen e aspekteve gjinore në zbatimin e marrëveshjeve që prekin jetën e popullatës.
39. Miratimin nga Kuvendi i Kosovës të ligjeve, përmes të cilave fuqizohet mandati dhe kapaciteti i Forcës së Sigurisë së Kosovës e kam marrë me shqetësim. Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit vazhdon të jetë korniza e vetme ligjore për praninë ndërkombëtare të sigurisë – KFOR-in. Në këtë drejtim, UNMIK-u do të vazhdoj të ketë bashkëpunim të ngushtë me KFOR-in.
40. Nën udhëheqjen e Përfaqësuesit tim Special, Zahir Tanin, Misioni do të vazhdojë t'i përqendroj aktivitetet e tij në përkrahje të ndërtimit të besimit mes komuniteteve, i cili është thelbësor për stabilitetin dhe kohezionin shoqëror të Kosovës, si dhe në krijimin e kushteve të volitshme për kompromis.
41. Po ashtu, dua të nënvizoj se mirëpres punën e vazhdueshme të UNMIK-ut, në bashkëpunim me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, lidhur me realizimin e rekomandimeve të përbashkëta nga Forumi i Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Besimit, të mbajtur në maj të vitit 2018. Përmes këtyre rekomandimeve udhëzohen angazhimet e Kombeve të Bashkuara në përkrahje të ndërtimit të besimit mes komuniteteve në partneritet me palët vendore e ndërkombëtare. Qasja e vazhdueshme e UNMIK-ut në financimet e programeve ia mundëson Misionit mbështetjen e aktiviteteve të nevojshme për ndërtimin e besimit, duke përfshirë në mes të tjerash edhe të drejtat gjuhësore, të drejtat e njeriut, fuqizimin e rinisë, barazinë gjinore dhe dialogun ndërmjet komuniteteve.

42. Mirëpres përparimin e arritur në punën e Grupit punues për personat e pagjetur lidhur me ngjarjet në Kosovë dhe njëkohësisht inkurajoj anëtarët e tij që ta shfrytëzojnë këtë moment për të siguruar përparim në çështjen e personave të pagjetur që është thelbësor për arritjen e pajtimit afatgjatë. Gjithashtu, mirëpres interesimin e shfaqur për dhënin e kontributit në fondin e mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara në përkrahje të komuniteteve romë, ashkallike dhe egjiptase, të prekura nga kontaminimi me plumb në Kosovë. Rrjedhimisht, inkurajoj shtetet anëtare dhe palët e organizatat e tjera që të kontribuojnë në fondin e mirëbesimit dhe të tregojnë përkrahjen ndërkombëtare për këto komunitete të cenueshme.
43. Dhuna në familje mbetet shqetësim serioz në Kosovë. Andaj, shfrytëzoj rastin për t'i nxitur institucionet e Kosovës në ndërmarrjen e më shumë nismave për trajtimin e dhunës në familje, duke përfshirë rritjen e përkrahjes në rehabilitimin dhe rintegrimimin e viktimave të dhunës në familje. Në këtë aspekt, financimi i qëndrueshëm institucional i shtëpive të sigurta është thelbësor.
44. Dua ta falënderoj Përfaqësuesin tim Special, Zahir Tanin, dhe të gjithë punonjësit e UNMIK-ut për energjinë, kreativitetin dhe përkushtimin për punën e Misionit. Gjithashtu, dua të theksoj falënderimet e mia për partnerët afatgjatë të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, KFOR-in, OSBE-në, Përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian dhe zyrat në terren, si dhe për Koordinatorin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, agjencitë, fondet dhe programet e OKB-së për punën e tyre të vazhdueshme dhe bashkëpunimin me UNMIK-un.

Shtojca I

Raport për Sekretarin e Përgjithshëm i Përfaqësues së Lartë të Bashkimit Evropian për punë të jashtme dhe politika të sigurisë mbi aktivitetet e Misionit për Sundimin e Ligjit në Kosovë prej datës 16 tetor 2018 deri më 15 janar 2019.

EULEX-i ka përfunduar rikonfigurimin më 14 dhjetor 2018, duke arritur kështu kapacitetin e tij të plotë operacional ashtu siç parashihet me mandatin e tij të tanishëm. Gjatë muajve të fundit të rikonfigurimit janë përfunduar një numër procesesh të brendshme dhe të jashtme, duke mundësuar kështu operacionalizimin e plotë të Misionit në përputhje me mandatin e tij të ndryshuar.

Deri në mesin e dhjetorit, EULEX-i ka finalizuar tranzicionin tek Zyra e BE-së të një numri të ish-detyrave të tij nga fusha e fuqizimit të Policisë së Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe të Regjistrat Civil. EULEX-i ia barti këto detyra zyrave ekzistuese dhe ndau raportet e tij të pranimit-dorëzimit nga fushat përkatëse të ekspertizës me punonjësit e angazhuar së fundmi të Zyrës së BE-së. Ngjashëm me këtë, në kuadër të përfundimit të kompetencave ekzekutive gjyqësore të Misionit, EULEX-i kreu pranimit-dorëzimin tek autoritetet e Kosovës të dosjeve të mbetura të policisë dhe prokurorisë.

Në kuadër të procesit të bartjes graduale të përgjegjësisë në fushën e sundimit të ligjit tek pala kosovare, në nëntor Misioni organizoi mbledhjen e fundit të Bordit të përbashkët për koordinimin e sundimit të ligjit, ku morën pjesë Përfaqësuesja Speciale e Bashkimit Evropian/shefe e Zyrës së BE-së, ministri i Drejtësisë dhe kryesuesit e Këshillave Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës. Në përmblyllje të kësaj forme të angazhimit, në përputhje me mandatin e tij të tanishëm EULEX-i u përkushtua për vazhdimin e kontributit të tij në të ardhmen lidhur me përkrahjen e reformave në fushat relevante të sundimit të ligjit në kuadër të Nismës vendore për Drejtësi 2020.

Deri më 15 dhjetor 2018 Misioni arriti strukturën e tij të paraparë pas finalizimit të procesit të punësimit të punonjësve ndërkombëtarë dhe vendorë, si dhe pas lamtumirës me punonjësit, postet e të cilëve nuk janë përfshirë brenda strukturës së rikonfiguruar. Që atëherë EULEX-i ka qenë plotësisht i dedikuar në zbatimin e mandatit të tij 2018-2020 përmes Shtyllave të tij për monitorim dhe operacione, me një numër të autorizuar punonjësish prej 503 ndërkombëtarëve dhe vendorëve.

2. AKTIVITETET E EULEX-IT

2.1. Monitorimi

Që nga fillimi i mandatit të tij të ri qershorin e kaluar, EULEX-i ka vazhduar monitorimin e lëndëve dhe gjykimeve të përzgjedhura në sistemin e drejtësisë të Kosovës, me theks të veçantë tek lëndët e bartura të EULEX-it, si dhe tek lëndët e tjera *ad hoc*. Në mes kriteresh të tjera juridike, lëndët e monitoruara janë vlerësuar edhe në bazë të përputhshmërisë së tyre me ligjin dhe me standardet e të drejtave të njeriut të Kosovës. Në këtë proces EULEX-i ka identifikuar në sistemin e drejtësisë sfidat vijuese: a) zvogëlimi i vonesave dhe parregullsive në ndarjen e lëndëve dhe në procedurat gjyqësore, b) zvogëlimi i numrit të seancave joproductive gjyqësore, c) kufizimi i numrit të rigjykimeve për vendimet e lëshuara nga gjykatat e instancave më të larta, d) rritja e kapaciteteve deri më tani të pamjaftueshme të ekspertëve të specializuar, e) sigurimi i pavarësisë së procedurave gjyqësore dhe

f) përmirësimi i kapaciteteve deri më tani të munguara prokuroriale në kryerjen e hetimeve të ndjeshme për korrupsion. Gjatë periudhës së rikonfigurimit, EULEX-i ka krijuar një sistem të raportimit, përmes të cilit do t'i këmbejë rregullisht të gjeturat e tij me palët vendore dhe partnerët ndërkombëtarë në mënyrë transparente dhe efikase.

EULEX-i ka mandatin për të monitoruar lëndët në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DhPGjS) dhe në Panelin e Ankesave të Agjencinë Kosovare të Pronave (AKP) pas tërheqjes së gjyqtarëve të tij ndërkombëtarë nga Dhoma dhe Paneli në fund të mandatit të tij paraprak më 14 qershor 2018. Deri më sot, autoritetet e Kosovës kanë ngecur në ndryshimin e këtyre ligjeve, posaçërisht kur kemi të bëjmë me heqjen e çfarëdo referimi në gjyqtarët ndërkombëtarë të EULEX-it, kështu që panelet të mund të formohen vetëm nga gjyqtarët vendorë. Për shkak të këtyre vonesave, DhPGjS-ja është jofunksionale që nga 15 qershori 2018, kur kryetari i Gjykatës Supreme caktoi dy gjyqtarë vendorë të Gjykatës Supreme si anëtarë të Panelit të ankesave të AKP-së sipas parimit të rotacionit si masë e përkohshme deri në ndryshimin e ligjit. Megjithatë, Paneli vazhdon të ketë vështirësi shtesë në realizimin e mandatit të tij, duke marrë parasysh se nuk i janë caktuar përkthyes shqip-serbisht pas përfundimit të mandatit ekzekutiv gjyqësor të EULEX-it më 14 qershor 2018. Së këndejmi, që nga ajo kohë aktgjykimet e formës së prerë nuk u janë dhënë palëve, pasi që Paneli nuk ka qenë në gjendje t'i ofrojë ato në të dy gjuhët zyrtare.

Pas vendimit të Gjykatës Supreme të qershorit të kaluar për ta dërguar në rigjykim ish-lëndën e EULEX-it për krime lufte Drenica I në Gjykatën themelore të Mitrovicës, ku përfshihen pjesëtarë të njohur të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), EULEX-i ka monitoruar këtë lëndë dhe lëndën e ndërlidhur me të Drenica II. Gjatë diskutimeve për ricaktimin e lëndës Drenica I në Gjykatën themelore të Mitrovicës, EULEX-i ka vërejtur se kryetari dhe gjyqtarët e gjykatës kanë qenë të papërgatitur dhe të shqetësuar për trajtimin e një lëndë me një profil aq të lartë, duke ngritur pyetje lidhur me kushtet e gjyqtarëve që të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. EULEX-i ka monitoruar dy seanca të Panelit për lirim me kusht për dy ish-komandant të UÇK-së. Më 24 tetor Paneli vendosi që të lirojë me kusht njërin prej tyre në bazë të sjelljes së tij të mirë, ndërsa kërkesa e tjetrit është refuzuar. Më 25 tetor, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga disa të akuzuar në rastin Drenica II, duke vërtetuar kështu aktgjykimin e EULEX-it. Rrjedhimisht, nuk ka pengesa ligjore në ekzekutimin e dënimit për gjashtë të akuzuarit në rastin Drenica II. Deri më tani, gjykata relevante ka miratuar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të dënimit për dy prej tyre, derisa të gjithë të tjerët u ankuan kundër vendimit të kryetarit të gjykatës për refuzimin e kërkesës për shtyrje.

Misioni ka vazhduar me monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e strukturave të larta udhëheqëse të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) me qëllim të përkrahjes së zhvillimit të mëtejshëm të një ekipi të konsoliduar dhe profesional të menaxhmentit të lartë, si dhe të zhvillimit të kapaciteteve, në mes të tjerash, për të luftuar ndërhyrjet e palejueshme dhe trajtimin preferencial të të burgosurve. Në këtë drejtim, procesi i konsolidimit të ekipit të strukturave të larta udhëheqëse nuk ka qenë i lehtë. Pas vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me anulimin e procesit të punësimit të drejtorit të përgjithshëm të ShKK-së, të datës 15 nëntor 2018, mediat kanë raportuar se Ministria e Administratës Publike ka ngritur padi kundër Bordit të Pavarur Mbikëqyrës dhe se gjykata më pas ka pezulluar anulimin e procesit të punësimit deri në shpalljen e vendimit për këtë rast. Së këndejmi, drejtori i përgjithshëm i ShKK-së, i emëruar në këtë pozitë në prill të vitit 2018, ka mbetur në këtë post në pritje të vendimit nga gjykata kompetente lidhur me procesin përkatës të punësimit.

EULEX-i ka monitoruar procesin e punësimit për 120 vende pune të zyrtarëve korrektues për Burgun e Sigurisë së Lartë dhe për Qendrën e Paraburgimit në Gjilan. Më 11 nëntor 2018, ShKK-ja ka organizuar një test me shkrim për 1500 kandidatë, ndërsa rreth 250 janë intervistuar në gjysmën e dytë të dhjetorit. EULEX-i ka vënë re se planifikimi dhe organizimi i testit me shkrim ka shënuar përmirësime të dukshme në krahasim me procesin e ngjashëm të punësimit nga vitet e kaluara.

Gjatë procesit të monitorimit, Misioni ka ardhur në përfundim se të burgosurit e profilit të lartë ende vazhdojnë të kenë trajtim të favorizuar gjatë vizitave spitalore. Gjatë këtyre vizitave, fjala bie, zyrtarët korrektues të ShKK-së nuk kanë kontakt të vazhdueshëm vizual me të burgosurit dhe shpesh ndodh që të mos kontrollojnë vizitorët ashtu si duhet. Si reagim ndaj kësaj, EULEX-i ka ndarë rekomandimet e tij me strukturat udhëheqëse të ShKK-së, duke rekomanduar në mes të tjerash, që ShKK-ja të përditëson rregulloren për ruajtjen e të burgosurve gjatë hospitalizimit dhe të rikrijoj mekanizimin e mbikëqyrjes së brendshme për zyrtarët korrektues të ShKK-së gjatë vizitave të tilla. Pas marrjes së këtyre rekomandimeve, në tetor të vitit 2018 drejtori i përgjithshëm i ShKK-së themeloi një grup të përbashkët punues. Grupi punues dorëzoi ndryshimet e propozuara të rregullores në dhjetor, të cilat do t'i shqyrtoj drejtori i përgjithshëm i ShKK-së.

Lidhur me zbatimin e Protokollit teknik për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) mes Prishtinës dhe Beogradit, të mbështetur nga BE-ja, nuk është shënuar ndonjë përparim i dukshëm. Takimet e për Protokollin teknik të MIK-ut në nivel lokal, regjional dhe qendror nuk janë organizuar pas anulimit të tyre me rastin e arrestimit nga Policia e Kosovës të drejtorit të Zyrës për Kosovë e Metohi të qeverisë së Serbisë në mars të vitit 2018. EULEX-i ka vazhduar me vizitat e të gjitha Pikave të Përbashkëta Kufitare (PPK) në përputhje me orarin e caktuar të takimeve lokale të MIK-ut, duke u takuar me të dyja autoritetet ndarazi. Atmosfera ka mbetur miqësore, me një shkallë të bashkëpunimit në nivel operacional në shumicën e PPK-ve.

Ndërtimi i PPK-së së përhershme në Merdarë ka ecur përpara, gjë që ua ka mundësuar të punësuarve që të hyjnë në objektin e ti administrativ në pjesën e parë të tetorit. Megjithatë, derisa pala e Prishtinës është vendosur në objekt, zyrtarët e Beogradit kanë mbetur në objektin e vjetër. Rrjedhimisht, vetëm një pjesë e PPK-së shfrytëzohet për kalimin e automjeteve, duke i obliguar udhëtarët që të kalojnë përmes dy kontrolleve në vende të ndryshme. Kur kësaj ia shtojmë edhe mungesën e përgjithshme të bashkëpunimit mes dy autoriteteve në PPK dhe kontrollin e ngadalshëm të trafikut nga ana e Beogradit, kjo rezultoi me pritje të gjata dhe të panevojshme dhe, herë pas herë, me kolona të gjata të veturave dhe kamionëve në PPK.

Misioni ka vazhduar me përkrahjen e zbatimit teknik të marrëveshjeve të mbështetura nga BE-ja lidhur me lirinë e lëvizjes. Në veriun e Kosovës EULEX-i ka vënë re një rritje të dukshme në regjistrimin e lindjeve, martesave dhe vdekjeve brenda sistemit të regjistrimit civil të Kosovës pas vendimit të korrikut 2018, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, për pranimin e dokumenteve të lindjes, martesës dhe të vdekjes, të lëshuara nga institucionet serbe që funksionojnë në Kosovë mes datave 10 qershor 1999 dhe 14 shtator 2016. Edhe pse Agjencia për Regjistrim Civil në gusht ka nxjerrë dokumentin e Procedurave standarde të punës për zbatimin e këtij vendimi, mosekzistimi i kuptimit dhe qasjes së unifikuar me rastin e trajtimit të aplikuesve ka mbetur sfidë në zbatimin e të njëjtit.

Misioni ka vazhduar me monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e kryetarit të Gjykatës themelore të Mitrovicës dhe të udhëheqësit të Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë. Kapacitetet e pamjaftueshme të përkthimit mes gjuhës shqipe dhe serbe ka qenë një nga sfidat kryesore për funksionalitetin e plotë të gjykatës dhe kanë ndikuar në shumë aspekte të punës së saj. Po ashtu, numri i pamjaftueshëm i interpretëve ka kërkuar nivel të lartë të bashkërendimit mes gjykatës dhe Zyrës së prokurorisë kur kemi të bëjmë me caktimin e seancave dëgjimore, duke marrë parasysh në çdo kohë gjuhën e folur të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe numrin në dispozicion të interpretëve, etj. Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të përkthyesve, gjykata ka qenë e ngadalshme në zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura, duke marrë parasysh se shumë lëndë kanë nevojë për përkthim në gjuhën shqipe apo serbe para se të trajtohen më tej. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) ka punësuar dy përkthyes në gjykatë, të cilët parashihet t'ia fillojnë punën në janar 2019. Për shkak të mungesës së kandidatëve të kualifikuar, KGjK-ja ka rishpallur konkurset për tre përkthyes të tjerë në gjykatë, si dhe për një përkthyes për Divizionin e Gjykatës së Apelit në Mitrovicë. Në mënyrë që përkohësisht të mbushet boshllëku në ofrimin e shërbimeve gjuhësore, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ka financuar 10 përkthyes me shkrim dhe interpretë për Gjykatën themelore të Mitrovicës në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh. Ata janë punësuar nga paneli përzgjedhës, ku ka qenë anëtar edhe kryetari i gjykatës, dhe ia kanë filluar punën në nëntor 2018.

Në nëntor, Këshilli Gjyqësor i Kosovës emëroi pesë gjyqtarë të ri shqiptarë në Gjykatën themelore të Mitrovicës. Pasi që gjyqtarët të dekretohen nga presidenti, gjykata më në fund do të arrijë kuotën e gjyqtarëve shqiptarë ashtu siç parashihet në Marrëveshjen për drejtësi të mbështetur nga BE-ja. Para marrjes së plotë të detyrave, këta gjyqtarë parashihet të vijojnë një trajnim praktik njëvjeçar.

2.2. Operacionet

EULEX-i ka vazhduar me ofrimin e përkrahjes për Policinë e Kosovës (PK) në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor. Në këtë drejtim, Misioni ka mbështetur këmbimin e informatave mes Byrove qendrore nacionale të Interpolit dhe Njësisë së PK-së për koordinimin e zbatimit të ligjit ndërkombëtar nën ombrellën e Zyrës ndërlidhëse të Interpolit dhe UNMIK-ut. Misioni gjithashtu ka vazhduar edhe me kanalin e këmbimit të informatave me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë.

Në përputhje me mandatin e tij dhe me kërkesë të autoriteteve vendore, EULEX-i vazhdon të jetë në dispozicion të Institutit për Mjekësi Ligjore në ofrimin e ekspertizës mjeko-ligjore, duke përfshirë edhe për personat e pagjetur. Në këtë aspekt, në nëntor të vitit 2018 janë organizuar takime mes EULEX-it, Ministrisë së Drejtësisë dhe Institutit me qëllim të hartimit të planit të përbashkët të veprimit për aktivitetet e ardhshme të Institutit. Në ndërkohë, mes datave 22 dhe 30 tetor, pas një kërkesë *ad hoc* me shkrim të Ministrisë së Drejtësisë, EULEX-i ndihmoi Institutin në realizimin e vlerësimit të një vendi ku dyshohej se kishte varrezë të mundshme të personave të pagjetur në komunën e Skenderajt, në bazë të një urdhri të Prokurorisë Speciale të Kosovës. Vlerësimi i këtij vendi nuk ka rezultuar me ndonjë gjetje.

Njësia policore e formuar nga EULEX (FPU) vazhdon të jetë reagues i dytë i sigurisë. Për të siguruar gatishmërinë operationale të FPU-së, e njëjta ka realizuar trajnime të rregullta të brendshme dhe trajnime të përbashkëta me KFOR-in dhe PK-në. Si reagim ndaj tensioneve të rritura në veri të Kosovës në pjesën e dytë të nëntorit, FPU-ja intensifikoi patrullimet e saj në atë zonë.

Në përputhje me legjislacionin përkatës, EULEX-i vazhdoi t'u ofroj përkrahje logjistike dhe operationale Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

3. Çështjet e tjera kryesore

Nuk ka asgjë të rëndësishme për t'u raportuar.

Shtojca II

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar

Gjatë periudhës raportuese Dhomat e specializuara vazhduan të përparojnë përkitazi me gatishmërinë e tyre për aktivitete gjyqësore, duke i rafinuar procedurat e tyre të brendshme dhe administrative dhe duke vendosur në faqen e ripërtërirë të internetit bazën publike të të dhënave të dosjeve gjyqësore. Tanimë faqja tregjuhësore e internetit mundëson paraqitjen e përmbajtjeve audio-vizuale, siç janë seancat gjyqësore, si dhe dërgimin e porosive në Twitter.

Më 1 nëntor Dhomat e Specializuara nxorën listën e përditësuar të avokatëve, e cila përmban 118 avokatë të pranuar qoftë si avokatë mbrojtës apo si avokat të viktimave. Muajin pasues u miratuan rregulloret e përkohshme për ndihmë juridike. Avokatët e kësaj liste kanë pranuar Draftkodin e mirësjelljes profesionale për avokatë, ku komentet dhe kontributet e tyre janë duke u shqyrtuar. Po ashtu, është duke u inkurajuar themelimi i një organi të pavarur përfaqësues për të gjithë avokatët.

Kanë vazhduar aktivitetet informuese në terren që janë thelbësore për strategjinë e komunikimit të Dhomave të Specializuara. Kështu, prej datës 19-22 nëntor, Dhomat e Specializuara, në bashkëpunim me Akademinë Ndërkombëtare të Parimeve të Nyrmbërgut, realizuan një seminar katërditor për gazetarinë dhe raportimin nga seancat gjyqësore në Nyrmbërg të Gjermanisë. Këtë trajnim me sukses e kanë vijuar 18 gazetarë të komuniteteve dhe mediave të ndryshme të Kosovës, të cilët patën mundësinë e diskutimit të sfidave dhe praktikave më të mira të raportimit nga seancat gjyqësore me ekspertë të fushës dhe gazetarë me përvojë, si dhe të kuptojnë më shumë për Dhomat e Specializuara, mandatin dhe rregulloret e tyre. Nga data 3-7 dhjetor, ekipi për aktivitetet informuese në terren së bashku me Zyrën për pjesëmarrjen e viktimave dhe një përfaqësues të Dhomave, në bashkëpunim me OJQ-të vendore, mbajtën takime informuese dhe tryeza të rumbullakëta me shoqërinë civile në zona të ndryshme të Kosovës. Gjithashtu në dhjetor, presidenti dhe sekretari i Dhomave morën pjesë në ngjarje gjatë Asamblesë së Palëve Shtetërore të ICC-së, të organizuar nga Oda Ndërkombëtare e Avokatëve, Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale dhe nga Nisma e Shoqërisë së Hapur për Drejtësi.

Angazhimi me shtetin nikoqir dhe me përfaqësitë diplomatike ka vazhduar. Më 28 nëntor, komandanti për operacione civile i BE-së, gjeneral Vinçenco Kopolla (Vincenzo Coppola) dhe shefja e Shërbimit të Komisionit Evropian për Instrumente të Politikave të Jashtme, Hilde Hardeman, vizituan Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, si dhe objektin e tyre të ardhshëm, ku u takuan me të tre drejtuesit dhe me autoritetet e shtetit nikoqir. Raportimi vjetor diplomatik është mbajtur më 4 dhjetor, ku morën pjesë përfaqësuesit e 27 shteteve anëtare të BE-së dhe të Shteteve të treta kontribuuese. Presidenti, sekretari dhe prokurori i specializuar dhanë informatat e fundit për zhvillimet e reja dhe iu përgjigjen pyetjeve të parashtruara. Po ashtu, gjatë periudhës raportuese, presidenti i Dhomave u takua me sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, ndërsa sekretari i Dhomave u takua me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe Sigurisë së Holandës dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Gjatë periudhës raportuese, janë angazhuar edhe 11 punonjës, duke e qar gjithsej numrin e të punësuarve në Dhomat e Specializuara dhe në Zyrën e Prokurorit të Specializuar më datën 15 janar 2019 në 180.

Gjatë periudhës raportuese, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka qar përpara hetimet e veta lidhur me pretendimet e Raportit të Këshillit të Evropës për trajtimin johuman të njerëzve dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë, duke rritur shkallën dhe intensitetin e aktiviteteve të saj. Gjatë këtij procesi, profili i Zyrës së Prokurorit të Specializuar ka shënuar rritje si në Kosovë, ashtu edhe në regjion më të gjerë, posaçërisht pasi që Zyra e Prokurorit të Specializuar filloi me dërgimin e ftesave ish-pjesëtarëve të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në fund të tetorit, Prokurori i specializuar Xhek Smith (Jack Smith) ka vizituar Kosovën për herë të parë me qëllim të mbajtjes së disa takimeve me zyrtarët ndërkombëtarë dhe me autoritetet e Kosovës. Në mes të tjerash, ai u takua me udhëheqësit e organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm, Zahir Tanin, përfaqësuesit e shteteve anëtare të BE-së, ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahiri, dhe zyrtarët e lartë të Ministrisë së tij.

Shtojca III

Përbërja dhe numri i komponentit policor të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (deri më datën 15 janar 2019)

<i>Vendi</i>	<i>Gra</i>	<i>Burra</i>	<i>Numri</i>
Austria	1		1
Bullgaria		1	1
Gjermania	1		1
Finlanda		1	1
Hungaria		2	2
Federata Ruse	1	2	3
Turqia		1	1
Gjithsej	3	7	10

Përbërja dhe numri i komponentit të ndërlidhës ushtarak të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (deri më datën 15 janar 2019)

<i>Vendi</i>	<i>Gra</i>	<i>Burra</i>	<i>Numri</i>
Republika Çeke	1	1	2
Polonia		1	1
Republika e Moldavisë		1	1
Rumania		1	1
Turqia		1	1
Ukraina	1	1	2
Gjithsej	2	6	8

